

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Elbasan, me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2013 – 31.7.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 787/7, datë 13.11.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 787/8, datë 13.11.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Qazim Sejдини Kryetar i Bashkisë, Elbasan.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga verifikimi i inventarit të familjeve të qytetit të Elbasanit, të cilat janë subjekt i detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, rezultoi se nuk janë përfshirë në planifikimin e të ardhurave 121 familje dhe si rrjedhojë nuk është planifikuar dhe arkëtuar shuma prej 459,800 lekë. (Trajtuar në faqen 21 të raportit). ***Për këtë rekomandojmë:***

Nga DTTV të ngrihet një grup pune i cili të hartojë një plan masash ku të detajohen veprimet konkrete dhe me afate të përcaktuara për verifikimin dhe kryqëzimin e të dhënave të sistemit të administrimit të detyrimeve vendore sipas rajoneve me të dhënat e gjendjes civile dhe të ndihmës sociale e invaliditetit, për të identifikuar 121 familjet që nuk janë përfshirë në planifikim dhe të merren masa sipas përcaktimeve ligjore dhe të VKB për llogaritjen, njoftimin dhe arkëtimin e shumës prej 459,800 lekë nga të cilat 290,400 lekë detyrime të vitit 2013 dhe 290,400 lekë detyrime të vitit 2014.

Menjëherë

2. Auditimi i mëparshëm nga KLSH në DTTV, Bashkia Elbasan është ushtruar në vitin 2013. Nga auditimi i zbatimit të detyrave të dërguara me shkresë nr. 571/6, datë 22.11.2013, u konstatua se masat për shpërblimin e dëmit janë zbatuar duke arkëtuar dëmin ekonomik të rekomanduar në shumën prej 4,020,000 lekë ose në masën 34.65 % duke mbetur pa u arkëtuar ende shuma prej 3,641,000 lekë. (Trajtuar në faqen 12 të raportit). ***Për këtë rekomandojmë:***

DTTV të ndjekë me përparësi, duke respektuar afatet, kërkimin në rrugë ligjore të arkëtimin të vlerës prej 3,641,000 lekë nga subjektet sipas shkresës së KLSH nr. 571/6, datë 22.11.2013, në bashkëpunim institucional me DRT Elbasan, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

3. Nga auditimi i dosjeve të subjekteve dhe sistemit elektronik të administrimit të taksave dhe tarifave vendore rezultoi që sistemi vendos në mënyrë automatike gjobë subjekteve që nuk respektojnë afatin e pagesës, në masën 25 % të detyrimit, pavarësisht nga numri i ditëve në shkelje të afatit. ***Për këtë rekomandojmë:***

DTTV në bazë të kontratës dhe marrëveshjes me subjektin “Datech” shpk, i cili përgjigjet për suportin e programit software të administrimit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa për modifikimet e mundshme me qëllim që në rastet e mos likuidimit në afatin e përcaktuar të detyrimit, subjektet të mos penalizohen menjëherë në masën 25 % të detyrimit por sipas përcaktimit në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ku gjoba për pagesat e vonuara duhet te jete e diferencuar në masën 5 % në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit.

Menjëherë

4. Nga auditimi i aktiviteteve për menaxhimin e borxhit rezultoi se për 229 subjekte juridik me borxh me vlerë 47,552,924 lekë dhe 636 subjekte fizik me borxh me vlerë 2,903,406 lekë nuk është bërë njoftimi i detyrimit, nuk janë ushtruar kompetencat për penalizimin e tyre në masën 25 % të detyrimit dhe vlera e borxhit nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2013, ku si rrjedhojë përveç borxhit në buxhetin e bashkisë duhej të arkëtoheshin dhe penailletet në shumën 11,888,231 lekë për subjektet juridike dhe në shumën 725,852 lekë për subjektet fizike. (Trajtuar në faqet 22-27 të raportit). ***Për këtë rekomandojmë:***

Nga DTTV, Bashkia Elbasan të merren masat e njoftimit të detyrimit për 229 subjekte juridik me borxh me vlerë 47,552,924 lekë dhe 636 subjekte fizik me borxh me vlerë 2,903,406 lekë, të bëhet penalizimi me 25 % të detyrimit përkatësisht 11,888,231 lekë për subjektet juridik dhe 725,852 lekë për subjektet fizik, bazuar në VKB nr. 6, datë 28.01.2014 si dhe në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuara, neni 89, sipas anekseve 8, 9, 10, 11 dhe në bashkëpunim me Zyrën e Financës të pasqyrohet vlera e borxhit ne 31.12.2014 në bilancin e institucionit.

Menjëherë

5. Nga verifikimi në sistem u konstatuan subjekte, të cilat nuk janë ndjekur e monitoruar duke bërë që të mos gjenerohen detyrimet për disa prej tyre si dhe të mos kontrollohen e detyrohen të shlyejnë detyrimet vendore për pjesën tjetër. (Trajtuar në faqen 22 të raportit). ***Për këtë rekomandojmë:***

DTTV, Sektori i Vlerësimit në bashkëpunim me Sektorin e Kontrolli, të bëjnë verifikimin në sistem dhe në terren të subjekteve sipas aneksit nr. 4, duke kryqëzuar të dhënat me DRT, Elbasan dhe QKR mbi statusin e tyre dhe të marrin masa të menjëhershme për njoftimin e detyrimit dhe arkëtimin e tij.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga DTTV, Bashkia Elbasan, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **7,928,474 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **1,528,176 lekë**, nga subjekte sipas anekseve 1 & 1 / 2 të raportit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të taksës së ndërtesës për sipërfaqet shtesë të shfrytëzueshme në shumën 1,222,541 lekë dhe penalitet në shumën 305,635 lekë, të evidentuara nga inventarizimi, për vitin 2013, trajtuar në faqen 18 të raportit.

Menjëherë

2. Vlera prej **2,550,000 lekë**, nga subjekte sipas anekseve 13 & 14 të raportit, penalitete për mos përditësim të të dhënave në DTTV, Bashkia Elbasan për periudhën 2013-2014, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, trajtuar në faqen 18 të raportit.

Menjëherë

3. Vlera prej **775,200 lekë**, nga subjektet ambulantë sipas aneksit nr. 3 të raportit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2014, trajtuar në faqen 22 të raportit.

Menjëherë

4. Vlera prej **2,170,220 lekë**, nga të cilat vlera prej 1,822,060 lekë nga subjektet e biznesit të vogël sipas aneksit nr. 15 të raportit, të cilat kanë aplikuar për ç' regjistrim nga viti 2012 e në vazhdim dhe në vitin 2014 është konstatuar se ushtrojnë normalisht veprimtarinë ekonomike në mungesë të llogaritjes, gjenerimit dhe arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore dhe vlera prej 348,160 lekë nga subjekte të paregjistruar në DTTV sipas aneksit nr. 16 të raportit, të cilat janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet ekonomik për vitin 2014, në mungesë të llogaritjes, gjenerimit dhe arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, trajtuar në faqen 29 të raportit.

Menjëherë

5. Vlera prej **60,000 lekë**, nga subjekti ".....", për mos llogaritje e mos arkëtim të detyrimeve për taksën e fjetjes në hotel, trajtuar në faqet 19-21 të raportit.

Menjëherë

6. Vlera prej **60,000 lekë**, nga të cilat vlera prej 30,000 nga subjekti "....." dhe vlera prej 30,000 lekë nga subjekti ".....", për mos llogaritje e mos arkëtim të detyrimeve për tarifën e pastrimit, trajtuar në faqet 19-21 të raportit.

Menjëherë

7. Vlera prej **784,878 lekë**, nga subjekte sipas aneksit 2 të raportit, penalitete për mos respektim të afateve të likuidimit të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, sipas përcaktimeve të nenit 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, trajtuar në faqen 22 të raportit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 115, datë 5.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan, që në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse disiplinore, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për nëpunësit civil të DTTV, Bashkia Elbasan sipas përgjegjësive përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albana Agolli, p/grupi, Albert Thoma, Bashkim Shehu dhe Edvin Stefani, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Bashkia Elbasan ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme me shkresë nr. 787/10, date 10.12.2014 ku ka vlerësuar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT